



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 319, datë 04.10.2021

PËR SHPALLJEN E 2 (DY) VENDEVE VAKANTE PËR NGRITJEN NË DETYRË TË PROKURORËVE NË PROKURORINË E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Në përputhje me nenin 6 dhe nenin 7 të Ligjit nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", nenit 159 pika 2 gërma "a", 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, 190 të ligjit nr.115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", i ndryshuar si dhe nenet 47 dhe 48 të ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Vendimin Nr. 6/2021 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për miratimin e numrit të përgjithshëm të prokurorëve në prokurorinë e posaçme", Rregulloren "Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar", të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e ndryshuar, me propozim të Komisionit Për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të shpallë fillimin e procedurave për plotësimin e 2 (dy) vendeve vakante për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) përmes procedurës së ngritjes në detyrë.
2. Njoftimi i vendeve vakante si dhe kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët do të publikohen në faqen zyrtare të institucionit.
3. Shprehja e interesit duhet të dorëzohet jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga shpallja e thirrjes në faqen zyrtare të institucionit dhe të dorëzohet në adresën:

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rruga "Ana Komnena", godina Poli i Drejtësisë, Ish Fusha e Aviacionit, Tiranë.

Mbi zarf duhet të shënohet: "Shprehje Interesi për prokuror për në SPAK".

Gjithashtu mund të dorëzohet dhe në formë elektronike në adresën: karriera@klp.al (në këtë rast të gjitha dokumentat duhet të jenë të skanuara bashkëlidhur kërkesës për aplikim). Shprehja e Interesit duhet të përmbajë shpjegimet e kandidatit për arsyet e kandidimit (letra e motivimit jo më shumë se 3 faqe A4).

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet ne faqen zyrtare të Këshillit.

